



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:156288

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05562642

KF.nr.277/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala dhe zyrtaren ligjore Arta Hyseni, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit NTP “Agro Com” me numër fiskal 600026729 me seli në Ferizaj, rr. “Rexhep Bislimi” nr.241, të cilën me autorizim e përfaqëson H.K., kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti, vlerësim tatimor, vlera e kontestit 40,122.90 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me 02.04.2024 në prezencë të përfaqësuesit të palës paditëse H.K., e në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit NTP “Agro Com” me numër fiskal 600026729 dhe seli në Ferizaj, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr.162/2021 i datës 18.06.2021, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës.
- III. DETYROHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit NTP “Agro Com” me numër fiskal 600026729 dhe seli në Ferizaj, t’ia kthej shumën e paguar më tepër prej 40,122.90 € (dyzet mijë e njëqind e njëzet e dy euro e nëntëdhjetë cent) me kamatë ligjore në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, në lidhje me secilin muajin kalendarik në mes të datës së pagesës, e gjer në pagesën definitive, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 15.07.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.162/2021 të datës 18.06.2021, me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit kundër njoftim rivlerësimeve shtesë të caktuara me kontrollë. Paditësi si në padi dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor të datës 02.04.2024 dhe me parashtesën me shkrim të dorëzuar gjykatës me datë 02.04.2027, ka theksuar se mbesin pranë padisë dhe kërkesë padisë si e drejtë dhe e bazuar, me kërkesë që gjykata të anulohet vendimin e kontestuar me arsyetim se e paditura nuk ka vepruar konform Aktgjykimit A.nr. 2826/18. Më tej ka shtuar se paditësja me datë 13.02.2020 ka ndryshuar statusin nga biznesi individual në shoqëri me përgjegjësi të pakufizuar dhe si dëshmi gjykatës i ka dorëzuar certifikatën e regjistrimit nga ARBK. Pretendimet e veta i ka arsyetuar se e paditura ka dështuar të sqaroj si ka ardhur deri te aplikimi i vlerës së hapur për paditësin, të sqaroj nëse paditësi për shitjet e bëra me pakicë ka lëshuar kuponë fiskal apo fatura. Shton se e paditura në njërin anë ka theksuar se paditësi ka lëshuar kuponë fiskal, ndërsa në anën tjetër ka bashkangjitur faturat e lëshuara nga paditësi që janë lëshuar në emër të qytetarëve. Lidhur me aplikimin e vlerës së hapur të tregut thekson se është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore pasi që informatat e marra nga palët e treta subjektet ANNEX SHPK, REAL COLOR, BLEDI COLOR, ESTETIKA, të njëjtit janë blerës të Agro com, respektivisht paditësit, dhe se nuk janë marrë në konsideratë kushtet elementare për aplikimin e saj siç janë: nuk bëhet fjalë për konkurrencë të drejtë, furnitorët janë të ndryshëm, kapacitetit e bizneseve dallojnë ngase paditësi është importues, ndërsa subjektet krahasuese furnizohen brenda vendit, andaj edhe çmimi i mallit nuk mund të jetë i ngjashëm ose i përafërt me çmimin e mallit të shitur nga paditësi. Gjykatës i ka kërkuar që të aprovoj padinë si të bazuar, të anulohet vendimin kontestues si dhe t'ia kthej shumën prej 40.122.90 euro të paguar në emër të tatimeve së bashku me interesin.

E paditura, në përgjigje në padi të datës 14.04.2022, ka deklaruar se është i paqëndrueshëm pretendimi i paditësit me aplikimin e vlerës së hapur të tregut të cilën e ka aplikuar inspektori në rastin konkret, për arsye se për shitjen e mallit me pakicë për një sasi të madhe të mallit të shitur, paditësi nuk ka identifikuar blerësin në bazë të faturave të bashkangjitura e të cilat nuk janë nënshkruar nga palët, andaj faturat e tilla janë të pavlefshme, kështu që inspektori ka vepruar sipas

ligjit duke e aplikuar metodën e marzhës dhe vlerën e hapur të tregut me të cilin rast e ka obliguar subjektin me tatim shtesë duke aplikuar vlerën e hapur të tregut çmimit me pakicë për shitjet që u janë bërë personave të pa identifikuar, bazuar në nenin 30 pika 3.30 të UA 15/2010. Tutje ka kundërshtuar pretendimet e paditësit se ATK ka dështuar të ofroj dëshmi konkrete për shitjen e mallit, ku përpos se e paditura ka ofruar dëshmi në dosjen A.nr.2826/2020 po ashtu konstaton se paditësi edhe vet ka deklaruar në intervistën fillestare (Pyetja e 23) të bëra para fillimit të kontrollit se kush janë blerësit e tij, andaj konstatojmë se shitësit e mallit janë ata të cilët vet i ka deklaruar. Me tej ka shtuar se ka rezultuar tatim shtesë duke përfshirë edhe ndëshkimet në vlerë prej 38,081.23 euro pas ekzaminimit të librit të blerjes, shitjes si dhe informatave nga palët e treta. Duke analizuar afarizmin që zhvillon paditësi dhe mallrat për blerësit e paidentifikuar i konsideron shitje të personave fizik apo konsumatorit final, sepse paditësi nuk ka identifikuar blerësit dhe ka vetëm shitje me shumicë dhe që rezulton se me afarizmin e këtyre mallrave paditësi nuk është në kushtet e tregut dhe konkurrencës së konsumatorit final. E paditura ftesën për seancë e ka pranuar me datë 21.03.2024, ndërsa me parashtresën e datës 02.04.2024, gjykatën e ka njoftuar se nuk do të prezantoj në seancën e datës 02.04.2024 me kërkesë që gjykata të vepron në pajtim me nenin 38 par 5 të LKA-së, duke deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi me kërkesë që të refuzohet ankesa/padia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.162/2021 i datës 18.06.2021 i ATK-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 02.04.2024, ka administruar provat si në vijim: Shkresa e datës 02.04.2024, Vendimi kontestues 162/2021 i datës 18.06.2021, Aktgjykimi A.nr. 2826/18 i datës 03.02.2021, Përgjigje në padi e datës 14.04.2022, Caktimi i rasteve për kontroll nga ATK, Lista e çmimeve me pakicë, Fatura për vitin 2015, 2016 dhe vitin 2017, Raporti i kontrollit i datës 29.08.2018, Fletat e punës, Lista e çmimeve me pakicë për mallrat e subjektit Agro Com, Pasqyra e tatim paguesit printuar me datë 06.04.2022, Certifikata e regjistrimit të paditësit e datës 13.02.2020.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën

Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata nga Raporti i Kontrollit i datës 29.08.2018, ka nxjerr konstatimin se ATK-Drejtoria Regjionale në Ferizaj, ka kryer vlerësim tatimor (kontroll tatimore), për këtu paditësin, për periudhat dhe llojet e tatimeve; Tatim mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) prej 01.01.2015-12/2017 dhe për Tatim në të Ardhura Personale për vitet 2015-2017. Me kontroll paditësi është ngarkuar me tatim shtesë për TVSH në shumë prej 10,449.33€, me tatim shtesë në Tatim në të Ardhura Personale në shumë prej 9,290.91€, ndëshkime administrative për këto dy lloje të tatimit në shumë prej 4,935.03€, zvogëlim të kreditimit në shumë prej 12,852.80€ dhe zvogëlim i rimbursimit në shumë prej 385.94€. Deri tek qarkullimi dhe tatimi shtesë me kontroll, zvogëlim i kreditimit dhe i rimbursimit për paditësin ka ardhur si rezultat i asaj që e paditura me kontroll ka konstatuar se paditësi ka pasur shitje të mallrave me pakicë në një sasi të madhe të mallit për vitet 2015-2017 në vlerë prej 3,526.321.70€, prandaj edhe ka aplikuar vlerën e hapur të tregut për këto shitje me pakicë, duke vlerësuar se kanë qenë shitje për biznese por nuk janë identifikuar si të tilla. Po ashtu e paditura nuk i ka njohur paditësit as shpenzimet e zhvlerësimit në vlerë prej 16,896.00€, për periudhën e kontrollit, për shkak se për veturën e tipit “Audi” në vlerë prej 28,160.00€, nuk është pranuar zhvlerësimi prej 20%, mirëpo kjo çështje nuk është kontestuar nga ana e paditësit në këtë konflikt administrativ. Departamenti i Ankesave i ATK-së duke vendosur në ri procedurë ankimore, me vendimin e kontestuar me nr.162/2021 i datës 18.06.2021, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar Njoftim Rivlerësimit e Tatimit Shtesë të caktuara me kontroll sipas Raportit të Kontrollit të datës 29.08.2018. E paditura në arsyetim të vendimit të kontestuar ka theksuar se Divizioni i Ankesave konstaton se vlerësimi zyrtar nga ana e ATK-së është bere komfor nenit 14, 15 dhe 19 të Ligjit Nr. 03/1-222 dhe sipas paragrafit 1, 2 dhe 3 të nenit 19 të ligjit nr. 03/L - 222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe nenit 29 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 për zbatimin e Ligjit nr. 03/1-222. Sa i përket pretendimit të tatimpaguesit se është importues dhe për shumicën e artikujve të krahasuar janë distributor ekskluziv për territorin e Kosovës, se ngarkesa tatimore është e padrejtë duke aplikuar metodën e marzhës dhe vlerën e hapur të tregut duke krahasuar çmimet e shitjes të katër bizneseve në treg e të cilët biznese kanë shitur pikërisht mallrat e blerë te Agro Com dhe ka rezultuar me një nën deklaram të qarkullimit. Divizioni i Ankesave pas analizimit të shkresave të lëndës ka vërtetuar nga raporti i kontrollit dhe

fletat e punës se ky vlerësim merret i besueshëm nga kontrolli pasi është vërtetuar gjendja faktike e tatimpaguesit duke e marrë tatimin shtesë si rezultat i nën deklaramit të qarkullimit nga tatimpaguesi për shitjet e mallit bizneseve përmes kuponëve të zakonshëm të shitjes me pakicë- qytetarëve, pa u definuar blerësi dhe duke e aplikuar vlerën e hapur të tregut nga informatat e palëve të treta sipas dispozitave ligjore Ligjit Nr. 0/L - 222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat Neni 15. Për krahasim ka marrë çmimet e shitjes nga subjektet: "Annex" SHpk ;"Real Color";"Bledi Color" Shpk dhe "Estetika". Prandaj, kontrolli për shitjet me kuponë fiskal ka aplikuar vlerën e hapur të tregut bazuar në nenin 24 të Ligjit 03/L-146 ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 3/L-197 dhe Ligjin Nr. 4/L-108 Ligjin nr.05/L-037 për TVSH. Ndërsa lidhur me kërkesën e gjykatës për ofrimin e dëshmisë konkrete për shitjet e mallit bizneseve, DA pas analizës së dokumentacionit në dosje konstaton se tatimpaguesi me datën 27.04.2018 në intervistën fillestare me numër rendor 23 në pyetjen se kush janë blerësit e juaj, tatimpaguesi ka deklaruar se blerësit janë bizneset e ndryshme dhe nga kjo vijmë në përfundim se tatimpaguesi duhet të lëshoj faturë tatimore dhe jo kuponë fiskal.

Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e aktit përfundimtar të të paditurës, përkatësisht vendimin kontestues nr. 161/2021, konstaton se e paditura edhe përkundër obligimeve nga aktgjykimi A.nr.2826/18 nuk i ka përfillur vërejtjet e dhëna në të njëjtin, ashtu që në vendimin kontestues ka ritheksuar të gjeturat e njëjta si në vendimin paraprak. Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, gjykata konstaton se e paditura nuk i është përgjigjur vërejtjeve të Gjykatës të dhëna në aktgjykimin A.nr.2826/18, ku përsëri ka theksuar se krahasimi i çmimeve të shitjes është marr nga subjektet "Annex" Shpk; "Real Color" ;"Bledi Color" Shpk dhe "Estetika", duke mos arsyetuar udhëzimin e dhënë me aktgjykimin e lartcekur se këto subjekte mallrat i kanë blerë pikërisht nga këtu paditësi dhe se aplikimi i nenit 24 par 2 të Ligjit për TVSH, në rastin konkret nuk gjen zbatim. E paditura nuk ka vlerësuar nëse me të vërtetë paditësi ka lëshuar kuponë fiskal për blerje "qytetare", por është mjaftuar me arsyetimin se paditësi në intervistën fillestare ka deklaruar se mallrat i shet bizneseve, dhe konstatimin e ka nxjerr mbi bazën e faturave të panëshkruara.

Me nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L222 përcaktohet se: *"Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit"*,

ndërsa me nenin 7 par 1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla, Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat, lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen.”* Nga dispozitat ligjore të lartcekura, Gjykata konsideron se barra e provës bie mbi palët ndërgjyqëse.

Në ri procedurë e paditura nuk ka vepruar konform vërejtjeve të gjykatës dhe ka dështuar të provoj se paditësi furnizimin e mallrave nuk e ka shoqëruar me faturë siç parashihet me nenin 45 ose 46 të Ligjit për TVSH, e që në rastin konkret e paditura aplikimin e vlerës së hapur të tregut duhet ta bëjë duke marr informatat nga subjektet e të së njëjtës veprimtari dhe në kushte të konkurrencës së barabartë. Nëse kjo nuk është e mundur atëherë duhet të zbatohet dispozita e nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit për TVSH dhe si vlerë e hapur e tregut të merret çmimi i blerjes-kostos i përcaktuar në kohën e furnizimit. E paditura përsëri ka vendosur duke u bazuar në deklaratën e paditësit se blerësit janë bizneset dhe ka konstatuar se i njëjti është dashur të lëshoj fatura dhe jo kuponë fiskal.

Me nenin 20 të UA 15/2010, në paragrafin 4 është përcaktuar se: *“Kuponi i regjistruarit të kesh-it. Secili person i angazhuar në shitje me pakicë (shitjet për klientin përfundimtar) duhet ta fusë atë transaksion në një regjistruar fiskal të keshit, apo pajisje 46 tjetër të aplikueshme sikurse është përshkruar në këtë Udhëzimin Administrativ, që lidhet me regjistruarit fiskal të keshit apo pajisjet elektronike fiskale. Duke pasur parasysh kërkesat për të dokumentuar origjinën e mallrave, një person që kryen blerje në shitjen me pakicë duhet të posedojë një kupon të regjistruarit të keshit që do të ofrojë evidencë dokumentuese për origjinën e mallrave në posedim. Megjithatë, për një blerje me pakicë për të kërkuar si shpenzim në një Deklaratë të Tatimit në të Ardhurat e Korporatave (në vijim TAK) apo Deklaratë e Tatimit në të Ardhurat Personale (në vijim TAP), një kupon i regjistruarit të keshit duhet të shoqërohet me një faturë sikurse është përshkruar në paragrafin 1, 2 apo 3 të këtij Neni, varësisht nga statusi i shitësit dhe blerësit. Një kupon i lëshuar nga një regjistruar i keshit duhet të përmbajë së paku elementet vijuese (specifikacionet teknike pasuese për arkat fiskale dhe pajisjet elektronike fiskale mund të kërkojnë elemente tjera shtesë në një format të veçantë, në të cilin rast një kupon i regjistruarit të keshit duhet të plotësojë ato elemente shtesë për të shmangur ndëshkimet): “.*

E paditura ka dështuar të sqarohet nëse kontrolli ka vlerësuar lëshimin e kuponëve fiskal. Gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit janë të bazuara dhe se e paditura nuk ka arsyetuar mjaftueshëm pretendimet e veta si dhe nuk ka sqaruar rezultatet e kontrollit dhe bazën ligjore për të cilat janë arritur konkluzionet ashtu siç e obligon neni 27 i UA 15/2010, përkatësisht paragrafi 7 nën par 7.7 pika 7.7.5.

Rrjedhimisht, Gjykata konform nenit 46 par 4 të LKA-së me të cilin përcaktohet se “*Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar,*” vendosi që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa vendimin lidhur me obligimin si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi me të cilin e paditura obligohet të kthej mjetet e paguara nga paditësi e mori konform nenit 46 par 5 të LKA-së, me të cilin përcaktohet se “*Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore.*”

Vendimi mbi kamatë në shumën e obliguar si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori konform nenit 82 par.4 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku është paraparë se “*Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t’i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*”.

Gjykata konform nenit 64, të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative me të cilin shprehimisht përcaktohet se në procedurën e konfliktit administrativ secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale, vendosi si në pikën IV të këtij aktgjykimi.

Nga të cekurat më lart, Gjykata konform nenit 43, par 1 dhe nenit 46 par. 1, 2, 3, 4, dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.277/22, datë 02.04.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.